



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE, LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 646 Prot.

Tiranë, më 11 /11/ 2013

Lënda: **Rekomandim për trajtimin me përparësi të familjeve rome në përfitimin e banesave sociale me qira.**

Drejtuar: **z. Viktor TUSHAJ  
KRYETAR  
BASHKIA LEZHË**

**L E Z H È**

I nderuar z. Tushaj!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Komisioneri në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KShH), është duke realizuar ditë të hapura në disa bashki, në kuadër të projektit “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë. Gjatë takimit në qytetin e Lezhës, Komisioneri dhe KShH ka marrë disa ankesa nga komuniteti rom për diskriminimin nga ana e Bashkisë Lezhë, gjatë procedurave të përfitimit të banesave sociale me qira të cila administrohen nga njësiti vendore.

Nga informacionet që kemi marrë gjatë ditës së hapur në Bashkinë e Lezhës, anëtarë të komuniteti rom pohojnë se ata diskriminohen krahasuar me pjesën tjeter të shoqërisë, duke



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

mos u trajtuar me banesa sociale me qira. Gjithashtu, ata pohuan se, në periudha të ndryshme kishin dërguar kërkesa për të përfituar banesa sociale me qira në Bashkinë Lezhë, por nuk kishin marrë në asnje rast përgjigje për kërkesat e tyre. Komuniteti Rom përgjithësisht është i regjistruar për të përfituar banesa sociale me qira dhe gati 90% e tyre marrin ndihmë ekonomike në qytetin e Lezhës.

Lidhur me strehimin dhe problematikën me të cilën ndeshet komuniteti rom theksojmë se Ligji 9232/2004 “*Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane*” (i *ndryshuar*), përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

Sipas pikës 1 të nenit 4 të ligjit 9232/2004 “*Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane*” (i *ndryshuar*), përfitojnë strehim individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a. nuk kanë në pronësi një banessë;
- b. zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;
- c. kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Në nenin 5, të ligjit 9232/2004 “*Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane*” (i *ndryshuar*), përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së familjeve duke parashikuar një sëre kushtesh<sup>1</sup>, ndërmjet të cilave edhe kushtet sociale. Në këtë nen, komuniteti rom nuk janë shprehimisht në kategorinë që duhet të trajtohet me përparësi. Neni 4/ pika 4 i këtij ligji i lë një hapësirë pushtetit

<sup>1</sup> Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

- a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
  - i) nuk disponojnë banesë në pronësi;
  - ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
  - iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktiveve dhe normave në fuqi;
  - iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.
- b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:
  - i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;
  - ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
  - iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
  - iv) çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç.
- c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:
  - i) personat me astësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategorji;
  - ii) personat me statusin e jetimit, që nga casti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç;

vendor në administrimin e kërkesave duke përcaktuar: “Se administrimi i kërkesave për përfitimin nga programet sociale të strehimit dhe caktimi i përparësive bëhet nga strukturat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore dhe miratohen me vendim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore, përvëç rasteve kur në ligje të veçanta përcaktohet ndryshe”. Kjo dispozitë i lejon bashkitë që të vendosin grupe prioritare, sipas aplikimeve që ato kanë.

Në planin e veprimit 2013-2015, Bashkia e Lezhës ka ndërmarrë angazime në fushën e strehimit dhe përmirësimi të infrastrukturës ku në objektivin nr 1, përkatohet: “Sigurimi i mundësive për strehim dhe përmirësimi i infrastrukturës në përputhje me standarde shtetërore në zonat me popullsi rome dhe egjiptiane.”

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon në nenin 11 “Marrjen e masave pozitive” për grupet vulnerabël, ku parashikohet: “Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtypjen e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet apo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”.

Kërkojmë nga ana Juaj, që në fryshtë e respektimit të ligjit dhe të drejtave e interesave të ligjshme të Komunitetit rom, të vlerësoni në mënyrë maksimale problemin e përfitimit të banesave sociale me qira, duke i dhënë përparësi komunitetit rom. Bashkia Lezhë, duhet ta shoh me përparësi ofrimin e mundësive për strehim.

Përsa më sipër, nisur nga situata e konstatuar, si dhe bazuar në kompetencat që neni 32 pika 1/“f” i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i jep institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **REKOMANDOJME:**

1. Marrjen e masave për trajtimin me përparësi të familjeve rome në përfitimin e banesave sociale me qira nga Bashkia Lezhë.
2. Këshilli Bashkiak i Lezhës të vlerësojë në mënyrë maksimale problemin e përfitimit të banesave sociale me qira, duke i dhënë përparësi komunitetit rom.
3. Dhënien e informacionit për individët që ju janë drejtuar me kërkesa për të përfituar nga programet e banesave sociale, bazuar edhe tek e drejta që ka çdo qytetar shqiptar për informim nga organet qendrore dhe vendore brenda një afati të arsyeshëm.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,



Konc: Kaliro Martiko

Specialiste DPLMJ



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)